

## I. GJENDJA E PERGJITHESHME EKONOMIKE E VENDIT

### 1.1. Gjeografia dhe klima, historia, gjuha dhe besimi fetar.

#### Gjeografia

##### Pozicioni gjeografik dhe relievi

Shqipëria ndodhet në perëndim të Gadishullit Ballkanik. Ajo shtrihet në gjerësi veriore  $39^{\circ}38'$ ,  $42^{\circ}39'$  dhe gjatësi lindore  $19^{\circ}16'$ ,  $21^{\circ}4'$ . Shqipëria kufizohet në veriperëndim dhe në veri nga Mali i Zi, në verilindje nga Kosova, në lindje nga Maqedonia, në juglindje dhe në jug nga Greqia. Në jugperëndim dhe perëndim ajo laget nga detet Jon dhe Adriatik. Shqipëria zë një sipërfaqe prej 28,748 kilometra katrorë.

Shqipëria është një nga vendet me malore të Europës. 76.6% e territorit të saj është malor dhe kodrinor. Lartësia mesatare e vendit është 708 metra, sa dyfishi i lartësisë mesatare të Europës. Maja më e lartë e relievit të Shqipërisë është mali i Korabit me lartësi 2751 metra mbi nivelin e detit. Në pjesën perëndimore, gjatë bregdetit Adriatik, gjendet Ultesira Perëndimore, që shtrihet nga veriu në jug në një gjatësi afro 200 km dhe që shkon në drejtim të lindjes deri në 50 km në brendësi të vendit. Në këto pjesë ka plazhe shumë të bukura që shtrihen shumë kilometra përgjatë vijës bregdetare.

Me poshtë paraqiten disa të dhëna numerike për gjeografinë e Shqipërisë

##### **Sipërfaqja:**

*totale:* 28,748 kilometra katrorë

*tokë:* 27,398 kilometra katrorë

*ujorë:* 1,350 kilometra katrorë

##### **Kufijtë tokësorë:**

*total:* 720 km

*kufijtë me vendet:* Greqi 282 km, Republika e Maqedonisë 151 km, Kosova e Mali i Zi 287 km

**Vija bregdetare:** 362 km

**Terreni:** Kryesisht malor dhe kodrinor; fusha të vogla përgjatë vijës bregdetare;

##### **Nivelet ekstreme:**

*pika më e ulët:* Deti Adriatik 0 m

*pika më e lartë:* Maja e Korabit (Golem Korab) 2,753 m

**Burimet natyrore:** nafte, gaz natyror, qymyr, krom, baker, lende drusore, nikkel, energji hidrike

**Perdorimi i tokes:**

*Toke are:* 21%

*toke bujqesore:* 5%

*kullota:* 15%

*pyje:* 38%

*te tjera:* 21% (1993 est.)

**Toke vaditese:** 3,410 kilometer katrore

**Mjedisi-problemet kryesore:** shpyllezimi; erozioni; ndotja e ujit nga mbetjet industriale.

**Klima**

Shqiperia ndodhet ne brezin klimatik Mesdhetar, qe karakterizohet nga vere e thate, me diellezim te forte dhe dimer i bute me reshje te bolleshme. Be mjaft dite te vitit, qielli ehste i kthjellat dhe me pak re'. Ne vartesi te pozicionit gjeografik vrojtohen 2000 deri ne 2800 ore faktike me diell. Klima eshte e ngrohte ne pjesen perendimore te vendit, qe ndodhet nen ndikimin e masave te ngrohta te ajrit qe vijne nga zona bregdetare. Temperatura maksimale e regjistruar ne kete zone ne Korrik, qe eshte dhe muaji me i nxehte i vendit, ehste 44°C ( e regjistruar ne Kucove, ne vitin 1973). Ne pjesen lindore te vendit, qe ndodhet kryesisht nen ndikimin e masave ajrore kontinentale, dimri eshte i ftohte. Temperatura minimale e regjistruar ne kete zone ehste -26°C (regjistruar ne Sheqeras -Korce, ne vitin 1963). Reshjet vjetore variojne nga rreth 800 mm ne pjesen juglindore dhe 1000-1200 mm ne ultesiren perendimore, ne rreth 2500 mm ne pjesen malore te vendit. Numri mesatar vjetor i diteve me reshje varion nga 100 deri ne 130 dite. Numri mesatar i diteve me bore arrin deri ne 40 ne pjesen malore veriore dhe juglindore te vendit.

Duke pasur parasysh faktin se Shqiperia laget nga detet Adriatik dhe Jon, dhe ne pjesen verilindore ka nje relief te thyer i cili pengon masat e ftohta ajrore qe vijne nga zonat kontinentale ballkanike. I gjithë vendi i neneshtrohet nje sere regjimesh klimatike gjate gjithë vitit edhe pse nje vend me siperfaqe te vogel. Zonat pergjate vijes bregdetare kane klime tipike Mesdhetare duke hasur nje ndryshim te dukshem klimatik nga veriu ne jug.

Zonat e uleta te vendit kane nje dimer te bute me nje tempereature mesatare 7°C. Temperaturat mesatare ne vere arrijne tek 24°C, shoqeruar me nje nivel te larte lageshtie. Ne pjesen jugore te vendit temperaturat jane zakonisht 5° me te larta se ne pjesen tjeter te vendit gjate gjithë vitit. Kjo diference zakonisht eshte me e madhe gjate veres dhe pak me e ulet gjate dimrit.